

BEQIR META**DISKUTIMET MIDIS QEVERISË SHQIPTARE DHE ASAJ
RUMUNE PËR PROBLEMIN E SHKOLLAVE TË PAKICËS
VLLAHE GJATË VITEVE 1925-1938**

Gjatë viteve 1912-1920 pakica etnokulturore vllahe kishte njohur një proces afirmimi brenda suazave të shtetit shqiptar. Ajo shquhej për marrëdhënie të mira, miqësore me shtetin e ri e popullsinë shqiptare dhe ishte e respektuar prej tyre. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se nuk kishte probleme që diskutoheshin dhe ndikonin në këto marrëdhënie. Më i rëndësishmi prej tyre ishte ai i shkollave vllahe ose rumune. Në kohën e sundimit osman kishte pasur shkolla rumune në Berat, Elbasan e Korçë, të cilat financoheshin drejtpërsëdrejti prej Rumanisë. Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë funksiononin vetëm shkollat e Korçës dhe Shpërkës të cilat fillimisht menaxhoheshin nga shteti rumun, ndërsa më vonë ndërhyri shteti shqiptar, duke emëruar edhe ai ndonjë mësues.

Qysh prej vitit 1920, qeveria shqiptare, duke dashur të vendoste një rregull të përgjithshëm në shkollat minoritare, kishte marrë në dorë administrimin e tyre, duke përballuar dhe shpenzimet financiare. Kjo masë, megjithëse nuk kishte ndonjë karakter armiqësor ndaj elementit vllah që jetonte në vëllazërim e miqësi të plotë me shqiptarët, në Rumani u gjykua si një masë e frymëzuar prej shovinizmit dhe kishte si qëllim shkombëtarizimin e vllahve të Shqipërisë. Qysh atëherë, Ministria e Jashtme e Rumanisë shprehu vazhdimisht pakënaqësinë e saj për këtë çështje dhe kërkoi që të gjendej një zgjidhje e kënaqshme për të dyja palët. Edhe shtypi rumun e trajtoi gjerësisht këtë problem dhe nacionalistët rumunë bënë vazhdimisht një propagandë armiqësore kundër Shqipërisë.

Pas rikthimit në pushtet të A. Zogut, përfaqësuesit e minoritetit vllah paraqitën disa kërkesa për zgjerimin e arsimit në gjuhën vllahe dhe për shtimin e kishave vllahe. Administratori i shkollave rumune në Shqipëri, Nikuca Harallamb Ballamaçi kërkoi që të çelehin ato shkolla dhe kisha arumune që kishin funksionuar në kohën e sundimit osman. Ai vinte në dukje se, qysh prej vitit 1885 deri në vitin 1915, arumunët kishin pasur 20 shkolla filllore e gjimnaze në qytete e katunde të cilat, për arsye të kohërave jonormale, ishin reduktuar në tre shkolla filllore në të gjithë

Shqipërinë. Ai i kërkoi Këshillit të Ministrave të lejonte “çeljen e shkollave kombëtare rumune kudo që ta kërkonte nevoja, duke marrë detyrimin se ato do të zbatonin e respektonin të gjitha ligjet e rregullat shkollore që ekzistonin dhe do t’i kushtojë një kujdes i veçantë gjuhës dhe historisë shqiptare”¹. Autoritetet shqiptare vinin në dukje se këto kërkesa ishin të frymëzuara nga ministri i Rumanisë në Shqipëri, Mandresku, i cili ndiqte një vijë nacionaliste. Ministria e Jashtme konstatonte se ky diplomat, qysh në fillim, kishte pasur si program politik njohjen e vllëve të Shqipërisë si një minoritet etnik nga ana e qeverisë shqiptare dhe çeljen e 20 shkollave rumune që ishte një numër shumë i madh. Ai kishte kërkuar çeljen e katër internateve në Tiranë dhe në Durrës. Synimi tjetër i tij ishte njohja e kishës vllahe si një kishë e pavarur. Kjo nxitje ishte reflektuar edhe në telegramin e komisionit të përrurimit të kishës vllahe të Korçës, dërguar Parlamentit Shqiptar në të cilin ishte prezantuar si “Komiteti Fetar i Komunitetit Vllah”. Ministria e Jashtme, pohonte se, ky telegram synonte të krijonte një precedent për njohjen e minoritetit vllah dhe ishte frymëzuar nga ministri rumun në Shqipëri². Telegrami shkaktoi debate të ashpra në parlament. U vendos që ai të mos merrej parasysh, por kisha vllahe në Korçë duhej t’i drejtohej drejtpërdrejt Këshillit të Lartë Fetar të Kishës Autoqefale Shqiptare në Korçë.

Ministria e Jashtme e Shqipërisë i kishte deklaruar ministrit rumun se politika që ai po ndiqte në Shqipëri “cenonte pavarësinë dhe njësinë kombëtare të Shqipërisë, sepse çelja e këtyre shkollave nuk do t’i sillte asnjë dobi elementit vllah të cilin shteti shqiptar nuk e konsideron si minoritet por si qytetar shqiptar që merr pjesë në fatet e shtetit shqiptar”³. Por, këto vërejtje nuk patën rezultat. Madje, ministri rumun, në mënyrë të pamatur, i deklaroi ministrit të Jashtëm të Shqipërisë se “populli shqiptar duhej të adoptonte kulturën rumune në Shqipëri”. Ministria e Jashtme e Shqipërisë e vlerësonte qëndrimin e ministrit rumun si një politikë personale, në kundërshtim me politikën tradicionale të Rumanisë, e cila

¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1925, dosja (më tej: D.) 234, fl.4. N. H. Ballamaçi, administrator i shkollave rumune në Shqipëri drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, 28 korrik 1925.

² *Po aty*, V. 1925, D. 138, fl.2-5. Ministria e Punëve të Jashtme për legatën shqiptare në Athinë, 13 dhjetor 1925.

³ *Po aty*.

“kishte pasur si qëllim konsolidimin e gjendjes shqiptare në Ballkan”⁴. Gjithashtu, ajo pohonte se “paria vllahe në Shqipëri e konsideronte fatale politikën e ministrit të Rumanisë”⁵. Ajo i kërkonte ministrit shqiptar në Athinë që t’ia transmetonte të gjitha këto të dhëna ministrit rumun në Athinë dhe t’i kërkonte atij që të njoftonte qeverinë e vet.

Këtë politikë nacionaliste të ministrit rumun e konfirmonte edhe përfaqësuesi britanik në Shqipëri, Robert Parr. Ai njoftonte Chamberlainin se, gjatë një takimi që kishte pasur me të, kishte mësuar se qeveria rumune synonte të çelte shkolla në Shqipëri për kucovllehtë.⁶ Ministri rumun kishte pohuar se ai nuk ishte diplomat, por një mësues filologjie. Vetëm ndjenja e detyrës dhe përkushtimi i përgjithshëm ndaj kulturës kishte bërë që të pranonte kërkesat e përsëritura të qeverisë së tij për të ardhur në Shqipëri. Ai i tha Parr-it se në Shqipëri kishte 150.000 rumunë të cilët, për nga gjaku, gjuha, ndjenjat dhe religjioni, nuk ishin as shqiptarë dhe as grekë. Fakti që shërbimet e kishës ortodokse kishin qenë në gjuhën greke ishte një aksident historik për të cilin ai shpresonte se, do të eliminohej së shpejti. Ai pranoi se po zhvillonte një propagandë shumë intensive për këtë qëllim, duke shkaktuar zemërimin e madh të kolegut të tij grek dhe, ndoshta, edhe të qeverisë shqiptare. Por, ai ishte i vendosur të vazhdonte rrugën e tij. Ai kishte mbledhur rreth 70-80 fëmijë të cilët i kishte dërguar në Rumani dhe shpresonte të dërgonte rreth 100 gjatë vitit 1925. Ndërsa vitin tjetër ai synonte që të hapte dy shkolla në Tiranë dhe një në Durrës në të cilat do të dërgoheshin mësues rumunë. Kështu, ai do të shihte se sa rumunë kishte në Shqipëri. Sipas tij, do të hapeshin shkolla të mesme rumune në mënyrë që administrata, ushtria e drejtësia shqiptare të drejtoheshin nga persona me arsimim rumun.

Parr mendonte se, ai synonte të arrinte diçka më tepër se sa afirmimi kulturor i vllëve. Ministri rumun donte të siguronte përfitime politike, duke krijuar një minoritet rumun në Shqipëri. Ai shpalosi hapur aspiratat nacionaliste, kur u përpoq të bënte edhe një krahasim midis politikës koloniale britanike dhe qëllimeve që ushqente ai për një ekspansion të shtetit rumun drejt jugut të Ballkanit, duke përdorur si element thelbësor popullsinë vllahe. Ai i tha Parr, se Britania e Madhe e kishte fituar fuqinë nga aftësia e saj për kolonizime. Rumania që ishte një shembull i një

⁴ *Po aty.*

⁵ *Po aty.*

⁶ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Foreign Office (më tej: *FO*), 371/10654. R. Parr nga Durrësi për Austen Chamberlain, 23 shtator 1925.

kolonie të madhe, do ta krijonte madhështinë e saj të ardhshme në bazë të një politike të ngjashme. Parr i shkruante Chamberlain-it se në Shqipëri kishte një numër të konsiderueshëm vllahësh në pjesë të ndryshme të vendit, disa prej të cilëve e quanin veten shqiptarë dhe disa të tjerë grekë. Por, ai asnjëherë nuk kishte dëgjuar, para se të vinte ministri Mandresku, që ndonjëri prej tyre të shfaqte ndjenja rumune. Ai shtonte se “njerëzit e thjeshtë shqiptarë ishin gjithmonë të gatshëm të pranonin diçka për asgjë dhe, meqë propagandistët rumunë po premtorin arsimim, rroba dhe ushqim falas për fëmijët që do t’u besoheshin atyre, ata mund të arrinin një farë suksesi. Por, përtej kësaj, ishte e vështirë që t’i kushtohej ndonjë rëndësi serioze një përpjekjeje kaq të hapur dhe të paturpshme për të krijuar një minoritet të padëshirueshëm, i cili nuk kishte ekzistuar më parë.”⁷

Megjithëse kundërshtonte aspiratat nacionaliste të ministrit rumun, qeveria shqiptare nuk dëshironte të dëmtonte marrëdhëniet me Rumaninë. Prandaj, ajo përpiqej të respektonte të drejtat themelore të vllahve dhe të ruante traditën e mirë të mëparshme të trajtimit miqësor të tyre. Pikërisht për këtë arsye ajo u mundua t’i vinte fre një tendence që u shfaq midis disa pjesëtarëve të kësaj pakice për të emigruar në Rumani,⁸.

Në fillim të vitit 1926, administratori i shkollave rumune në Shqipëri, Ballamaçi u përpoq të rriste nivelin e arsimimit në gjuhën rumune. Ai i kërkoi ambasadës rumune që të mbështeste kërkesën e tij për transformimin e shkollës fillore të Korçës në gjimnaz. Për këtë çështje u zhvilluan bisedime midis Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit të Shqipërisë dhe legatës rumune, por nuk u arrit ndonjë marrëveshje⁹.

Qeveria rumune po përpiqej të vepronte me kujdes dhe, në aparcencë, qëndronte një hap më prapa se legata rumune në Shqipëri. Por, në të vërtetë, siç do ta tregonin ngjarjet e mëvonshme, ajo kishte nxitur ministrin Mandresku të tentonte krijimin e një minoriteti rumun në Shqipëri pa dalë hapur se ky ishte një projekt i qeverisë rumune, por duke e paraqitur si një përpjekje pasionante personale të Mandreskut. Në një bisedë me ministrin e Shqipërisë në Bukuresht, ministri i Jashtëm rumun, Duka deklaroi se qeveria e tij dëshironte të shtojë një klasë në shkollën

⁷ *Po aty*, FO 371/10654. R. Parr nga Durrësi për Austen Chamberlain, 23 shtator 1925.

⁸ *AMPJ*, V. 1926, D. 263, fl.1. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 3 janar 1926.

⁹ *AQSH*, F. MPB, V. 1926, D. 267, fl.1. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës së Korçës, 7 shkurt 1926.

rumune të Korçës; të mësohej gjuha rumune prej profesorëve shqiptarë që jepnin mësim në shkollat kombëtare në ato lokalitete ku arumunët përbënin një masë kompakte. Por, ai nënvizoi se qeveria rumune nuk kishte asnjë synim që të kërkonte ndaj Shqipërisë akordimin e të drejtave të një autonomie shkollore për vllehtë dhe, gjithashtu, nuk kërkonte që atyre t'u akordoheshin të drejtat e minoriteteve. Ministri i Jashtëm rumun shfaqti kënaqësinë e tij të madhe për trajtimin vëllazëror që u bëhej kucovllahëve në Shqipëri¹⁰.

Ministri i Rumanisë në Shqipëri vijonte të këmbëngulte në qëndrimin e tij nacionalist, duke e ekzagjeruar shumë problemin e shkollave rumune. Madje, ai botoi edhe një artikull me këtë frymë në gazetatat rumune "Dimineata" dhe "Independance Roumaine", gjë që shkaktoi ndërhyrjen e të Ngarkuarit me Punë të Shqipërisë në Ministrinë e Jashtme rumune. Sekretari i Përgjithshëm i MPJ të Rumanisë i tha përfaqësuesit shqiptar, "në mënyrë konfidenciale", se ministri rumun në Shqipëri po e ekzagjeronte çështjen dhe kërkoi që problemi i shkollave të zgjidhej sa më shpejt me qëllim që t'u mbyllej goja kundërshtarëve¹¹. Zyrtarët e Ministrisë së Jashtme rumune i cilësonin këto qëndrime të përfaqësuesit rumun në Shqipëri si qëndrime personale e nacionaliste dhe shpreheshin se nuk i jepnin rëndësi veprimeve të tij¹².

Në vjeshtën e vitit 1926 në Shqipëri erdhën disa mësues nga Rumania për të dhënë mësim në shkollat vllahe. Legata shqiptare e Bukureshtit e kishte mbështetur ardhjen e tyre, duke gjykuar se kjo do të ndikonte pozitivisht në marrëdhëniet midis dy vendeve¹³. Mirëpo, aktiviteti i tyre në Shqipëri binte në kundërshtim me legjislacionin shqiptar dhe me traktatet e Lidhjes së Kombeve të cilat nuk lejonin që në shkollat private të jepnin mësim nënshtetas të huaj. Prandaj, Ministria e Jashtme sugjeroi që mësuesit rumunë të mos pranoheshin dhe të mos shkeleshin dispozitat ligjore sepse, në rast të kundërt, do të krijohesh një

¹⁰ AMPJ, V. 1926, D. 214, fl.14. Ministri i Shqipërisë në Bukuresht, H. Vrioni, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 13 shkurt 1926.

¹¹ Po aty, V. 1926, D. 109, fl.4-5. Legata shqiptare në Bukuresht për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 23 prill 1926.

¹² Po aty, V. 1926, D. 214, fl.8. Legata e Shqipërisë në Bukuresht për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 14 shtator 1926.

¹³ Po aty, fl.7. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 26 tetor 1926.

precedent i dëmshëm për politikën arsimore të shtetit shqiptar¹⁴. Megjithëse qeveria shqiptare i pranoi mësuesit rumunë, duke shkëlur ligjin shqiptar, marrëdhëniet me ta nuk kaluan pa probleme. Gjatë një inspektimi që iu bë shkollës private rumune të Korçës, rezultoi se mësuesit nuk zhvillonin programin zyrtar të shtetit shqiptar por programin e klasave të ulëta të gjimnazit të Rumanisë¹⁵. Gjithashtu, autoritetet arsimore të prefekturës së Korçës konstatonin me shqetësim se këta mësues mbaheshin dhe paguheshin prej një shteti të huaj dhe, kështu, po u jepeshin të drejta shkollave propagandistike të huaja. Ata e konsideronin këtë lëshim të dëmshëm, po të mbahej parasysh madhësia e elementit vllah dhe propaganda e fuqishme që kishin filluar vllahët kohët e fundit për hapjen, organizimin dhe forcimin e shkollave të tyre¹⁶. Në këtë kohë në Korçë dhe në Plasë kishte nga pesë mësues, rroga e të cilëve varionte nga 120 deri në 250 fr.ari¹⁷.

Këshilli i Ministrave mori në shqyrtim gjendjen e krijuar në shkollat rumune dhe konstatoi se në shkollat e popullsisë kompakte vllahe të qarkut të Korçës, që ishin çelur në bazë të artikullit 6 të Deklaratës së Shqipërisë për minoritetet, ishte krijuar një gjendje që nuk i përshtatej interesave të shtetit, pasi në to ishin shtuar klasa liceu dhe ishin punësuar mësues me nënshtetësi të huaj, të emëruar e të paguar prej shteteve të huaja, të cilët nuk kishin respektuar programin zyrtar në ato shkolla. Ai vendosi ndalimin e menjëhershëm të klasave të liceut që ishin hapur në shkollat e sipërpërmendura, duke lënë vetëm shkollat fillore me klasat e caktuara për to, të cilat do t'i nënshtroheshin programit dhe inspektimit qeveritar. U vendos pushimi i menjëhershëm i mësuesve që nuk ishin shtetas shqiptarë dhe u emëruan, në vend të tyre, mësues shqiptarë të zgjedhur e të paguar prej komunitetit vendas dhe që miratoheshin nga Ministria e Arsimit¹⁸.

Në vitin 1927, funksiononin tri shkolla rumune. Shkolla plotore e qytetit Korçë me 133 nxënës (98 djem dhe 35 vajza), shkolla e fshatit

¹⁴ *Po aty*, fl.6. Ministria e Punëve të Jashtme për Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit, Tiranë, 26 tetor 1926.

¹⁵ *AQSH*, F. MA, V. 1927, D. 61, fl.6. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit për Ministrinë e Drejtësisë.

¹⁶ *Po aty*, fl.37. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 3 janar 1927.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *AMPJ*, V. 1927, D. 208, fl.27. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 254, 26 korrik 1927.

Plasë me 120 nxënës (75 djem dhe 45 vajza) e me 5 klasa, shkolla e Shpiskës me 30 nxënës (27 djem dhe 3 vajza) me pesë klasë. Mësuesit e këtyre shkollave merrnin një rrogë më të madhe se mësuesit e shkollave shqipe pasi paguheshin nga qeveria rumune. Këto shkolla nuk pranuan të zbatonin programin e shkollave publike shqiptare në atë vit. Natyrisht, kjo rezistencë bëhej me nxitjen e qeverisë rumune. Pas presioneve të autoriteteve shtetërore, ata u bindën të respektonin këtë program por përsëri konstatoheshin mjaft të meta¹⁹.

Megjithatë, dukej se, Ministria e Arsimit ishte e angazhuar të zgjeronte arsimin në gjuhën rumune edhe në disa fshatra të tjera që banoheshin nga një popullsi relativisht kompakte vllahe. Ajo i sugjeroi Këshillit të Ministrave që në katundet Dishnicë, Grabovë, Nicë, Llëngë të qarkut të Korçës, nxënësve t'u mësohej edhe gjuha amtare. Kjo favorizohej edhe nga fakti se në tre katundet e fundit mësuesit zyrtarë ishin të aftë të jepnin gjuhën vllahe. Ajo propozonte gjithashtu që në Liceun e Korçës t'u mësohej fakultativisht nxënësve që vinin prej këtyre fshatrave edhe gjuha vllahe²⁰. Këto shkolla u çelën dhe në buxhetin e Ministrisë së Arsimit u planifikuan 30 000 fr.ar për shkollat rumune²¹.

Qysh prej vitit 1927-1928, shkollat vllahe u bënë shtetërore. Në to, bashkë me gjuhën rumune, mësohej detyrimisht edhe shqipja. Ato përdornin libra të shkollave të Rumanisë të cilat kontrolloheshin më parë nga Ministria e Arsimit.

Këtë vit mësuesit e shkollave vllahe i zhvillonin mësimet sipas programit zyrtar që zbatoheshin në të gjitha shkollat shtetërore dhe private.²²

Qeveria rumune nuk ishte e kënaqur me këto masa. Legata rumune në Shqipëri kërkoi dhënien e autonomisë shkollore të popullsisë arumune të Shqipërisë, duke iu referuar edhe në këtë rast lidhjeve, miqësisë tradicionale dhe mbështetjes që kjo popullsi i kishte dhënë pavarësisë së Shqipërisë. Legata konfirmonte se “deri në këtë kohë, gjithçka kishte shkuar mirë për arumunët, të cilët s'kishin pasur shkaqe ankesash për

¹⁹ *AQSH*, F. MA, V. 1927, D. 61, fl.56. Inspektorja e Arsimit Korçë drejtuar Ministrisë së Arsimit, 26 gusht 1927.

²⁰ *Po aty*, F. MA, V. 1927, D. 187, fl.1. Ministria e Arsimit drejtuar Këshillit të Ministrave, 9 tetor 1927.

²¹ *AMPJ*, V. 1927, D. 208, fl.59. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar konsullatës së Përgjithshme Shqiptare në Bukuresht, 24 tetor 1927.

²² *Po aty*, fl. 71-72. Ministria e Arsimit drejtuar Komunitetit Ortodoks Shqiptar në Bukuresht.

trajtimin e tyre”²³. Por, ajo ankohej se masa e marrë nga qeveria shqiptare ditët e fundit, që mësuesit e shkollave rumune të ishin shtetas shqiptarë, kishte shkaktuar hidhërim të madh. Legata kërkonte që këta mund të ishin edhe nënshtetas rumunë. Ajo propozonte që shkollat rumune në Shqipëri t’i mbante qeveria rumune me shpenzimet e veta. Legata ankohej se, me këtë vendim, komuniteti arumun trajtohej në mënyrë të diskriminuar në raport me komunitetet e tjera të huaja në Shqipëri. Ajo theksonte se zotimet e marra prej Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, për mbajtjen e shkollave minoritare, nuk e pengonin qeverinë shqiptare të lejonte subvencionimin e shkollave arumune nga shteti rumun. Sipas saj, ky lëshim nuk do të krijonte, siç dyshonte qeveria shqiptare, një precedent prej të cilit do të përfitonin edhe kombësitë e tjera të Shqipërisë, sepse asnjë analogji nuk mund të aplikohet për rastin e arumunëve. Ky lëshim do të justifikohet me marrëveshjet analoge që tre shtetet e tjera ballkanike (Greqia, Bullgaria dhe Serbia) kishin lidhur me Rumaninë për shkollat e arumunëve²⁴. Këtë argument qeveria rumune do ta potenconte me forcë vazhdimisht më tej, duke dashur të minimizonte dhe tejkalonte pengesat ligjore që vinin prej Traktateve të LK dhe Deklaratës Shqiptare.

Ministri rumun protestoi edhe për masat që mori qeveria për mbulimin e shpenzimeve të shkollave rumune nga buxheti i shtetit dhe për kontrollin e këtyre shkollave nga administrata e arsimit. Ai theksoi se këto masa kishin bërë përshtypje të keqe në opinionin publik dhe tek qeveria rumune, e cila i shihte ato si një rrezik kërcënues, jo vetëm për ruajtjen e karakterit rumun të atyre shkollave por edhe për ekzistencën e tyre. Qeveria rumune kërkonte që t’u jepej autonomia shkollave rumune dhe që ajo të kishte të drejtën t’i subvenciononte këto institucione kulturore si dhe ato që do të krijoheshin në të ardhmen, nën mbikëqyrjen e qeverisë shqiptare²⁵.

Ministria e Arsimit e hodhi poshtë kategorikisht këtë kërkesë si të papranueshme, pasi ajo kishte bindjen e fortë se autonomia e shkollave rumune në Shqipëri do të krijonte një precedent të dëmshëm për minoritetet e tjera. Ajo, theksonte se, shkollat rumune kishin tashmë një

²³ *AQSH*, F. Kryeministria, V. 1927, D. IV-221, fl.2-6. Promemorie e legatës rumune në Shqipëri, 4 janar 1928.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ *AMPJ*, V. 1928, D. 290, fl.41. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar Këshillit të Ministrave, 5 janar 1928.

personel të aftë, i cili përbëhej nga shtetas shqiptarë. Ato funksiononin në rregull dhe po i siguronin kulturën dhe gjuhën amtare popullsisë vllahe. Kështu që nuk ishte aspak i nevojshëm subvencionimi i tyre nga ana e qeverisë rumune²⁶.

Projektet e qeverisë shqiptare për funksionimin ligjor të shkollave arumune i mbështeste edhe drejtori i shkollës vllahe të Korçës. Mirëpo, ai u akuzua nga një mësues i kësaj shkolle, me shtetësi serbe, si përkrahës i politikës së qeverisë shqiptare. Kështu, ministri rumun në Tiranë e urdhëroi zyrtarisht këtë mësues që t'i dorëzonte shkollën dhe vulën e komunitetit vllah ish mësuesit Dhimitri Anastasesku. Ky i fundit ishte nënshtetas serb i ardhur para pak kohësh në Shqipëri, i cili kishte sjellë me vete rrogat e mësuesve të tjerë të mbetur jashtë kuadrit të emëruar nga autoritetet shqiptare. Në këtë çështje ndërhyri dhe Drejtoria e Arsimit të Korçës. Ajo kërkoi që shkolla të mos i dorëzohej mësuesit me shtetësi serbe, i cili po i dërgonte raporte Ministrisë Rumune kundër rregullimit ligjor të shkollave²⁷. Duke konstatuar këtë veprimtari, Ministria e Brendshme dha urdhër që mësuesi me shtetësi serbe të dëbohej nga Shqipëria, dhe paralajmëroi se do të internoheshin të gjithë ata mësues që do të merrnin pagesa nga shtete të huaja, duke përfshirë këtu edhe ata që paguheshin nga Rumania²⁸.

Në maj të vitit 1928, legata rumune në Tiranë i dërgoi një notë tjetër qeverisë shqiptare në të cilën theksohej se, pas përfundimit të Traktatit të Bukureshtit më 1913 ndërmjet shteteve ndërluftuese ballkanike dhe Perandorisë Osmane, u arritën edhe disa marrëveshje midis Rumanisë, nga njëra anë, dhe Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë, nga ana tjetër. Në këto marrëveshje shtetet e lartpërmendura ballkanike angazhoheshin t'u jepnin autonominë shkollave dhe kishave të kuqovllehve. Regjimi kulturor e fetar i rumunëve që banonin në Shqipëri ishte rregulluar formalisht nga e njëjta marrëveshje, meqë në atë kohë shteti shqiptar nuk ishte konstituuar. Më vonë, qeveria rumune bëri demarshet e nevojshme pranë qeverisë shqiptare që shkollat rumune të Shqipërisë të vazhdonin të funksiononin si në regjimin otoman, duke e gëzuar këtë autonomi.

²⁶ AQSH, F. Kryeministria, V. 1927, D. IV-221, fl.5-6. Ministria e Arsimit drejtuar Këshillit të Ministrave, 4 shkurt 1928.

²⁷ Po aty, F. MPB, V. 1928, D. 217, fl.4. Prefektura e Korçës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 5 shkurt 1928.

²⁸ Po aty, fl.5. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Korçë, 8 shkurt 1928.

Në të vërtetë shtetet ballkanike të përmendura nga legata rumune, ndonëse ishin zotuar para qeverisë rumune, nuk u kishin akorduar një autonomi të tillë shkollave vllahe. Gjithashtu, Shqipëria nuk mund të obligohej as formalisht prej një marrëveshjeje të cilën nuk e kishte nënshkruar dhe nuk kishte qenë palë.

Legata rumune ankohej se masat e reja që kishte marrë qeveria shqiptare, duke i shtetëzuar shkollat rumune, u kishin dhënë një karakter kulturor të ndryshëm nga ai që kishin shkollat e vllëve në rajonet e tjera të Ballkanit. Ajo kërkonte që qeveria shqiptare, nën shembullin e shteteve ballkanike, duhej të pranonte të njëjtat marrëveshje për arumunët si ata në Greqi, Serbi e Bullgari. Ajo shtonte se marrëveshjet e lartpërmendura nuk ishin denoncuar pas Traktatit të Paqes dhe se privilegjet e dhënies së autonomisë shkollore një popullsie me origjinë tjetër nuk përbënin asnjë cenim ndaj prestigjit të shtetit ku ekzistonin këto pakica. Si rrjedhim, edhe në Shqipëri, autonomia shkollore e arumunëve do të ishte në pajtim me Paktin e Lidhjes së Kombeve, i cili nuk i ndalonte shtetet t'u akordonin popullsi të huaja që banonin në territoret e tyre një trajtim të tillë. Edhe në Shqipëri dhënia e kësaj autonomie nuk duhej të interpretohej si një cenim i sovranitetit dhe i prestigjit të shtetit shqiptar.

Legata rumune e cilësonte si një gënjesh të frikën e qeverisë shqiptare se i njëjti trajtim mund të kërkohej nga popullsia dhe shtete të tjera të huaja, pasi këto shtete, ku popullsia kucovllahe gëzonte një trajtim të veçantë nga nacionalitetet e tjera, nuk do të kërkonin kurrë që në shtetin shqiptar, regjimi shkollor i minoriteteve të ishte i ndryshëm nga ai që ishte përcaktuar në territoret e tyre.²⁹ Si përfundim, qeveria rumune kërkonte që, në bazë të një marrëveshjeje me qeverinë shqiptare, shkollat fillore dhe të mesme rumune në Shqipëri të administroheshin nga vllëhtë, me ndihmën materiale të qeverisë rumune, dhe të kontrolloheshin nga qeveria shqiptare. Ky do të ishte në fakt konfirmimi i regjimit shkollor që ekzistonte në Shqipëri para shtetëzimit të këtyre shkollave.

Nacionalistët filorumunë nuk ndenjën duarkryq. Ish drejtori i shkollës rumune të Korçës, Kushan Araja organizoi rrahjen e mësuesve vllahë që jepnin mësim në shkollat e Korçës, me qëllim që t'i frikësonin

²⁹ *AMPJ*, V. 1928, D. 290 fl.9-12. Aide-Memoire e legatës mbretërore rumune drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Tiranë, 5 maj 1928.

ata dhe t'i detyronin të hiqnin dorë nga statusi i tyre si mësues të emëruar nga shteti shqiptar³⁰.

Qeveria rumune nuk u mjaftua me përpjekjet e ministrit të saj në Tiranë. Në qershor u organizua në Bukuresht një takim midis konsullit të Shqipërisë, krerëve të komunitetit shqiptar në Rumani dhe disa personaliteteve rumune, si ministri i Arsimit Angjelesku, senatori Gradishteau, kryetari i shoqërisë Maqedono-Rumune, deputeti Lalesku, publicisti N. Batzaria dhe avokati V. Mushi. Në këtë takim, pala rumune lexoi raportet e ministrit të Rumanisë në Shqipëri, J. Trandafilesku, sipas të cilave qeveria shqiptare kishte ndryshuar qëndrimin mirëdashës ndaj vllahve, duke shkëlur të gjitha premtimet e dhëna, miqësinë dhe vëllazërinë shekullore të dy kombeve. Këtë e kishte bërë vetëm për një çështje të thjeshtë, siç ishte lejimi i 3-4 shkollave që të vepronin lirisht në Shqipëri, me atë status që kishin pasur para pavarësisë së Shqipërisë. Pala rumune këmbëngulte se këto shkolla nuk do t'i sillnin asnjë dëm shtetit shqiptar i cili mund t'i kontrollonte në çdo kohë, sepse ato nuk kishin si qëllim të mbillnin mendime dhe ide subversive por, përkundrazi, do t'i shërbenin zhvillimit të shtetit shqiptar.

Marinesku këmbënguli sërish se ishte i pabazuar shqetësimi i palës shqiptare se, kështu, do të krijohej një precedent për fqinjët e Shqipërisë të cilët mund të kërkonin çeljen sërish të shkollave greke e serbe në të gjithë Shqipërinë. Sipas tij, marrëveshja shqiptaro-rumune për shkollat do të bëhej mbi baza reciprociteti dhe shtetet fqinjë të Shqipërisë nuk mund ta përdornin atë si argument për t'i imponuar asaj lëshime të tjera në çështjen e shkollave. Rumania premtonte se do të lejonte hapjen e shkollave shqipe në territorin e saj. Kështu, nëse grekët e serbët donin të çelnin shkolla në Shqipëri, ata, në bazë të reciprocitetit, duhej të hapnin shkolla shqipe në vendin e tyre, gjë të cilën ata nuk e pëlqenin. Të gjithë folësit rumunë u dhanë diskutimeve të tyre një karakter miqësor³¹. Në këtë takim, Dhimitër Berati, i cili ishte përfaqësues i komunitetit shqiptar në Rumani, u shpjegoi përfaqësuesve rumunë se qeveria shqiptare ishte nisur nga një frymë miqësore për të rregulluar funksionimin e shkollave arumune. Pas këtij takimi, krerët e komunitetit të shqiptarëve të Rumanisë vendosën t'i dërgonin një letër Presidentit A. Zogu, në të cilën

³⁰ *AQSH*, F. MPB, V. 1928, D. 217, fl.15. Drejtori i shkollës arumune nr.1 në Korçë, Gjini Katundi, për Ministrinë e Arsimit, 1 qershor 1928.

³¹ *AMPJ*, V. 1928, D. 290, fl.20-22. Konsullata e Përgjithshme e Shqipërisë në Rumani për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 13 qershor 1928.

do të bënin propozime se si të rregullohej çështja e shkollave rumune³². Ndërsa shoqata e studentëve universitarë maqedono-rumunë mbajti një tubim në Bukuresht, ku u artikuluan akuza të ashpra e të rënda kundër popullit shqiptar. U kërkua edhe shpërndarja e komunitetit shqiptar në Rumani, mbyllja e shkollave shqipe dhe ndalimi i gazetave shqipe në Rumani³³.

Në të vërtetë problemi i shkollave vllahe po bëhej shqetësues për marrëdhëniet shqiptaro-rumune. Propozimet më të fundit të përfaqësisë rumune në Tiranë kishin qenë: qeveria shqiptare t'u jepte autorizime komuniteteve vllahe për të çelur shkolla; shkollat në të cilat po mësohej në gjuhën rumune t'u dorëzoheshin komuniteteve përkatëse vllahe; mësuesit, nënshtetas shqiptarë, të propozoheshin prej komunitetit vllah dhe të aprovoreshin nga Ministria e Arsimit; mësimet të zhvilloheshin në gjuhën rumune, por të jepej edhe gjuha shqipe, gjeografia dhe historia e Shqipërisë, sipas programit të shtetit; shkollat dhe kishat rumune të mbaheshin prej komuniteteve dhe, me pëlqimin e qeverisë shqiptare, prej ndihmave të Rumanisë³⁴.

Ministria e Arsimit mbante një qëndrim kategorik kundërshtues ndaj propozimeve të lartpërmendura dhe ishte kundër çdo ndryshimi të statusit të shkollave vllahe. Ndërsa Ministria e Jashtme sugjeronte një qëndrim më elastik. Ajo mendonte se mund të gjendej një kompromis për këtë çështje i cili nuk do të dëmtonte interesat kombëtare të Shqipërisë dhe, njëkohësisht, do të ishte një provë miqësie kundrejt Rumanisë. Për arritjen e kësaj marrëveshjeje ajo nisej nga këto konsiderata: ndjenjat e mirënjohjes për vendin ku u lind Lëvizja Kombëtare Shqiptare, për t'i dëshmuar miqësinë dhe simpatinë popullit dhe qeverisë rumune për ndihmën që u kishin dhënë shqiptarëve, jo vetëm në kohën e Perandorisë Osmane por edhe në Konferencën e Londrës, ku Rumania ishte përpjekur për një zgjerim sa më të madh të kufijve tanë; elementi arumun në Shqipëri kishte punuar dhe luftuar gjithmonë krah për krah me udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare; ekzistenca e këtij elementi në Shqipëri, jo vetëm nuk ishte rrezik për Shqipërinë por, përkundrazi, duke tërhequr interesimin e Rumanisë, mund të ndikonte për forcimin dhe zgjerimin e lidhjeve politike midis dy mbretërive; Rumania ishte një

³² “Çështja e shkollave rumune në Shqipëri”, *Shqipëri e Re*, Bukuresht, 1 korrik 1928.

³³ “Çështja e shkollave rumune në Shqipëri”, *Shqipëri e Re*, Bukuresht, 30 shtator 1928.

³⁴ *AMPJ*, V. 1928, D. 290, fl.23-24. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar Këshillit të Ministrave, dokumenti është pa datë.

shtet i madh ballkanik, me 17 milion banorë, e cila luante një rol kryesor në Antantën e Vogël dhe kishte influencë në çështjet ndërkombëtare, veçanërisht në ato ballkanike. Kështu, nuk ishte interesi i Shqipërisë të kishte marrëdhënie të ftohta me këtë shtet për shkaqe të vogla e të parëndësishme. Miqësia me Rumaninë ishte edhe më e vlefshme për arsye se Shqipëria kishte marrëdhënie të ftohta me shtetet ballkanike si Jugosllavia, Greqia dhe Turqia, me të cilat edhe Rumania nuk kishte marrëdhënie të mira, veçanërisht me sllavët; Përderisa qeveria shqiptare ankohej për qëndrimin e serbëve dhe grekëve kundrejt minoriteteve shqiptare, kryesisht për mohimin e të drejtave arsimore, ishte mirë që Rumania të ishte mbështetëse dhe jo kundërshtarë e kërkesave të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në forume të tjera ndërkombëtare. Ankesat e saj kundër Shqipërisë në këto organizma ishin shumë të dëmshme nga pikëpamja morale dhe do të shërbenin si armë në dorën e kundërshtarëve të Shqipërisë; Rumania kishte arritur marrëveshje për çështjen e shkollave të elementit rumun me Greqinë e Bullgarinë. Ajo po i subvenciononte drejtpërsëdrejti shkollat e atjeshme dhe po zhvillonte bisedime edhe me Jugosllavinë, në bazë të angazhimeve të marra nga Serbia në Traktatin e Bukureshtit. Kështu që, kur në Rumani flitej për të drejtat e minoriteteve rumune, përmendej Jugosllavia dhe Shqipëria si të vetmet shtete ku vllehtë nuk kishin shkollat e tyre, gjë që ishte e papëlqyeshme dhe e padrejtë.

Ministria e Jashtme mendonte se mund të arrihej një marrëveshje, pa njohur asnjë lloj autonomie dhe ndërhyrje të huaj por vetëm duke u bazuar në interesin e shtetit që pasqyrohej gjerësisht në ligjet e tij dhe në Deklaratën që kishte bërë Shqipëria në Lidhjen e Kombeve. Artikulli 5 i kësaj Deklarate përcaktonte se minoritetet në Shqipëri kishin të drejta legale të mbajnë, të drejtojnë e të kontrollojnë me të hollat e tyre shoqëri mirëbërëse, shkolla etj., duke pasur të drejtë të përdorin lirisht gjuhën dhe të ushtrojnë lirisht fenë e tyre³⁵.

Legata britanike konstatonte se vllehtë po fitonin një peshë të madhe në Shqipëri ndonëse ishin një grup i vogël. Diplomati britanik Jordan, në një raport të tij shkruante se “vllehtë formojnë një minoritet shumë të vogël, por me shumë influencë në kufijtë e Shqipërisë. Ata janë blegtorë, por po shkollohen me shpejtësi dhe e mbajnë një sy tek tregtia. Kështu shumë dyqanxhinj në qytetet Durrës, Tiranë, Vlorë janë me origjinë

³⁵ *Po aty.*

vllahe. Ata flasin një dialekt të arumanishtes dhe konsiderohen se janë pasardhës të ilirëve.”³⁶

Ndërkohë qeveria rumune vijonte të ushtronte presion. Sekretari i Përgjithshëm i MPJ të Rumanisë, Gafenku thirri në shtator të vitit 1929 konsullin e Shqipërisë dhe i deklaroi hapur se të gjitha veprimet që kishte bërë legata rumune në Tiranë kishin mbështetjen e qeverisë rumune³⁷.

Në këtë kohë, qeveria shqiptare u përball me një valë tjetër emigrimi të vllëve në Rumani. Gazetat rumune më 18 nëntor 1929 njoftuan se kishin arritur në Konstancë 100 vllahë prej Shqipërisë së Jugut. Këta i kishte sjellë qeveria rumune me shpenzimet e saj për t’i vendosur në Dobruxhën e Jugut, përgjatë kufirit bullgar. Emigrimi mendohej se ishte shkaktuar nga problemet ekonomike. Më parë vllëhtë merreshin me tregtinë e karvanëve, së cilës po ia zinte vendin automobili. Po kështu kishte rënë ndjeshëm profesioni i rrobaqepësisë, i cili ushtrohej nga vllëhtë. Profesioni më i rëndësishëm i tyre, blegtoaria, ishte dobësuar për shkak të vështirësive për kullota. Mirëpo, MPJ e Shqipërisë nuk mendonte se këto ishin shkaqet e vetme të këtij emigrimi. Ajo konstatonte se në Rumani po vepronte një grup njerëzish, të cilët e kishin kthyer në një biznes fitimprurës nxitjen e emigrimit të vllëve të Shqipërisë në Rumani. Nën maskën e nacionalizmit, duke i shërbyer edhe qëllimit të qeverisë rumune, ata po bënë më shumë një punë për interesin e vet, pasi merrnin shpërblime nga të shpërngulurit. Ndërsa në Shqipëri, nxitësit dhe organizatorët kryesorë të këtij emigrimi ishin sarafi korçar Dhimitër Tezha dhe konsulli i Rumanisë në Sarandë³⁸. Shumë prej vllëve që u vendosën në Dobruxhë u penduan shpejt që kishin lënë vendin e vet, duke dëgjuar fjalët e atyre që thonin se “në Rumani mblihdeshin napolonat me grusht”.

Ministria e Jashtme e Shqipërisë reagoi ndaj këtij fenomeni dhe kërkoi marrjen e masave për frenimin e tij. Ministri i Jashtëm Rauf Fico i shkruante Ministrisë së Punëve të Brendshme se “vllëhtë, sikurse duket mirëfilli, banojnë në Shqipërinë e Jugut prej shumë shekujsh më parë.

³⁶ TNA, FO 371/ 13559. Memorandum i diplomatit britanik Jordan për Shqipërinë, dërguar R. Hodgson nga Howard Smith, FO, 28 shkurt 1929.

³⁷ AMPJ, V. 1929, D. 999, fl. 1. Konsulli i Shqipërisë në Rumani për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 12 shtator 1929.

³⁸ AQSH, F. MPB, V. 1929, D. 50, fl.5. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 8 janar 1930.

Ata kanë qenë dhe janë një element punëtor i vlefshëm dhe inteligjent. Në luftën e rilindjes kombëtare ata kanë qenë gjithmonë bashkë me prijësit e kësaj lufte. Ekzistenca e këtij elementi e ka shtuar interesimin e Rumanisë për të mirën e shtetit shqiptar në kohën e krijimit të tij dhe më vonë”³⁹.

Në vitin 1930, qeveria rumune bëri një përpjekje tjetër pranë qeverisë shqiptare për shtimin e shkollave rumune në Shqipëri. Ajo i kërkoi sërish qeverisë shqiptare që t’ua dorëzonte komuniteteve vllahe shkollat ekzistuese të Korçës e të Shpëskës; mësuesit e propozuar prej komunitetit të emëroheshin me aprovimin e Ministrisë së Arsimit; mësimet të zhvilloheshin në gjuhën rumune por në këto shkolla të mësohej edhe gjuha shqipe, gjeografia dhe historia e Shqipërisë, duke ndjekur programin e shtetit shqiptar; shkollat dhe kishat rumune të mbaheshin prej komuniteteve të formuara legalisht, me dhuratat dhe me pagesat e anëtarëve të këtyre komuniteteve por edhe me ndihmën e Rumanisë, pasi kjo të miratohej nga qeveria shqiptare⁴⁰.

Ministria e Arsimit i dha një përgjigje kategorike negative këtyre kërkesave⁴¹. Ajo kundërshtoi çeljen e shkollave të tjera rumune dhe konsideroi shtetëzimin e shkollave rumune të Korçës e të Shpëskës të dobishëm për shtetin shqiptar. Gjithashtu kundërshtonte emërimin e mësuesve nga komuniteti dhe ndryshimin e programit mësimor. Ministria e Arsimit kërkonte që të ruhej *status quo-ja* e shkollave vllahe në Shqipëri, pasi kjo “ishte në interes të arsimit dhe të njësisë e të bashkimit kombëtar”. Në qoftë se do të lejohej hapja e shkollave rumune, do të nxitej edhe elementi i pakët bullgarofon që të kërkonte shkolla bullgare. Kështu do të hapej një plagë e re në trupin e ortodoksëve shqiptarë, në të cilin gjendeshin të përhapur në mënyrë sporadike vllehtë. Në këtë mënyrë, vllehtë do të ftoheshin e do të largoheshin prej kombësisë e arsimit shqiptar dhe do ta kthenin mendjen dhe vështrimin nga një komb e kulturë e huaj. Interesi i lartë kombëtar kërkonte që qeveria shqiptare të mos bëhej shkaktare për t’i quajtur vllehtë minoritetet, sepse “ata nuk formonin një madhësi të konsiderueshme dhe kompakte në popullsinë e

³⁹ *Po aty*, fl.1. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 16 dhjetor 1929.

⁴⁰ *AMPJ*, V. 1930, D. 288, fl. 33. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 7 prill 1930.

⁴¹ *AQSH*, F. MA, V. 1930, D. 56, fl. 2-3. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 15 prill 1930.

Mbretërisë Shqiptare dhe nuk kishin aspak ndjenja rumune”. Në raportin e Ministrisë së Arsimit, theksohej se, edhe në kohën e Perandorisë Osmane, ato pak shkolla rumune që ishin hapur, nuk ishin kërkuar prej vllahve por, prej disa personave të paktë të shtyrë prej politikës rumune⁴².

Mirëpo, disa muaj më vonë, qeveria shqiptare u tërhoq disi nga ky pozicion. Gazeta “Shqipëria e Re” shkruante se shkollën rumune të Korçës e mori përsëri në dorëzim komuniteti vllah, me privilegjet që kishte pasur më parë por, në përputhje me ligjet e shtetit shqiptar. Drejtor i shkollës u emërua Nikuca Harallamb Ballamaçi. Gazeta, shkruante se, edhe shkollat e tjera rumune në Shqipëri do të trajtoheshin si ajo e Korçës⁴³. Ajo e konsideronte tërheqjen e qeverisë shqiptare nga shtetëzimi i mëparshëm i shkollave rumune një zgjidhje të kënaqshme si për vllhtë ashtu edhe për qeverinë shqiptare. Ajo, pohonte se, kjo marrëveshje mund të ishte arritur me kohë, në qoftë se në gjirin e komunitetit arumun nuk do të kishte patur grindje, pasi udhëheqësit e tij ishin në mosmarrëveshje me njëri-tjetrin për interesa të ndryshme⁴⁴.

Në vitin 1931, problemi i shkollave vllahe ishte zgjidhur. Funksionin të dyja shkollat me 8 mësues dhe me 188 nxënës⁴⁵. Shtypi i shoqërive Maqedono-Rumune reagoi pozitivisht ndaj masave që kishte marrë qeveria shqiptare. Fletorja “Apërarea” botoi më 11 janar 1931 një letër të dr. Dumitru Shanazu nga Korça, i cili informonte se ishin çelur përsëri shkollat arumune në qytetin e Korçës dhe në Shpëskë dhe tani gjendja e tyre ishte e mirë. “Në këtë mënyrë, - shkruante ai, - ishte rregulluar njëherë e përgjithmonë kjo çështje që pengonte vëllazërinë tradicionale shqiptaro-rumune”. Ai pohonte se në Shqipëri lëvizja kulturore arumune ishte parë me sy të mirë dhe me simpati, si nga qarqet zyrtare ashtu dhe nga populli shqiptar, “me të cilin arumunët jetonin në harmoninë më perfekte”⁴⁶. Zgjidhjen e kësaj çështjeje e përshëndeste edhe gazeta e shqiptarëve të Rumanisë, e cila vinte në dukje se tashmë ishin larguar pengesat që zbehnin miqësinë shqiptaro-rumune⁴⁷. Edhe

⁴² *Po aty*.

⁴³ “Shkolla rumune e Korçës”, *Shqipëria e Re*, Bukuresht, 12 nëntor 1930.

⁴⁴ “Letra nga Korça”, *Shqipëria e Re*, Bukuresht, 21 nëntor 1930.

⁴⁵ *AQSH*, F. MA, V. 1931, D. 31, fl. 1. Pasqyrë e shkollave minoritare në Shqipëri në vitin 1930-1931.

⁴⁶ “Çështja e shkollave rumune në Shqipëri në shtypin arumun të Bukureshtit”, *Shqipëria e Re*, Bukuresht, 28 janar 1931.

⁴⁷ “Miqësia shqiptaro-rumune”, *Shqipëria e Re*, Bukuresht, 22 mars 1931.

takimi i kryeministrit rumun Jorga me Ekrem Libohovën, që u zhvillua më 21 shtator në Bukuresht, kaloi në një atmosferë tepër miqësore dhe të dy palët nënvizuan besnikërinë e elementit arumun ndaj shtetit shqiptar dhe miqësinë e përjetshme midis tyre dhe shqiptarëve⁴⁸.

Në këtë kohë pati edhe ndonjë kërkesë për çeljen e shkollave të tjera vllahe. Pleqësitë e fshatrave të Dishnicës dhe të Grabovës i kërkuan Ministrisë së Arsimit çeljen e shkollave rumune në fshatrat e tyre. Ministria e Arsimit pohonte se banorët e këtyre katundeve asnjëherë më parë nuk e kishin shfaqur veten e tyre si rumunë dhe, për këtë arsye, mendonte se kjo kërkesë ishte nxitur “nga një dorë e tretë vetëm për interesa personale”⁴⁹. Nga hetimet që zhvilloi për këtë problem prefektura e Korçës konstatoi se nxitës i kësaj kërkesë kishte qenë Nikuca Ballamaçi dhe at Kosta Ballamaçi, respektivisht mësuesi dhe prifti i vllahve të Korçës⁵⁰.

Midis shqiptarëve dhe arumunëve u krijua një traditë e re politike gjatë jetës së shtetit të pavarur shqiptar. Pakica arumune nuk u trajtua aspak si e tillë në jetën politike e administrative të shtetit shqiptar. Kështu në Parlamentin Shqiptar kishte disa deputetë arumunë që përfaqësonin zgjedhësit shqiptarë dhe të dyja palët nuk kishin komplekse apo mosbesim ndaj përkatësisë së tyre. Në një rast kur gazeta “Kosova” shkruajti se Andon Beça, Zoi Xoxa dhe Vlash Dovana ishin përfaqësues të pakicës rumune në Shqipëri, gazeta “Besa” botoi një artikull kritik, në të cilin pohonte se deputetët e lartpërmendur kishin deklaruar se ishin përfaqësues të popullit shqiptar dhe jo të ndonjë pakice⁵¹. Duke i bërë jehonë ndjenjave miqësore ndaj vllahve, gazeta shkruante se “po të mos bëhej një shembull i keq për të huajt e tjerë, ne mund t’u akordnim çdo gjë arumunëve. Aq i duam me zemër dhe nuk i kemi aspak frikë shkombësimi. Sikur të kishin të gjithë shtetet atë simpati reciproke dhe ato marrëdhënie të ngushta e të përzemërta që kemi me Rumaninë, me të vërtetë s’do të kishte nevojë për pakte e traktate, sepse do të jetonim si dy vëllezër në harmoni shembullore”⁵².

⁴⁸ “Shqipëria e Rumania”, *Miku i Popullit*, Tiranë, 2 tetor 1931.

⁴⁹ *AQSH*, F. MPB, V. 1931, D. 156, fl.1. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 11 dhjetor 1931.

⁵⁰ *Po aty*, fl. 3. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 7 janar 1932.

⁵¹ “Pakicat e huaja në Shqipëri”, *Besa*, Tiranë, 13 dhjetor 1932.

⁵² *Po aty*.

Megjithëse komuniteti vllah kishte fituar të drejtën të mbante dhe drejtonte vetë shkollat, vështirësitë nuk ishin kapërcyer. Shumë shpejt u pa se ky komunitet ndeshte në vështirësi administrative dhe financiare për mbajtjen e tyre. Në fundin e vitit 1932, një grup vllahësh të Korçës i kërkuan autoriteteve lokale që shkolla vllahe e qytetit e cila prej dy vjetësh mbahej nga Këshilli i komunitetit vllah, të futej përsëri nën varësinë e Ministrisë së Arsimit, ashtu siç kishte qenë para dy vitesh. Arsyeja e kësaj kërkese ishin kontradiktat e ashpra që ishin shfaqur këto dy vite midis vllahëve. Një pjesë e vogël e tyre nuk e pranonin si kryetar të komunitetit at Kosta Ballamaçin, i cili ishte drejtor i shkollës vllahe dhe për faktin se kjo shkollë nuk funksiononte në rregull dhe nuk kishte nivelin e dëshiruar të mësimdhënies⁵³. Edhe prefektura e Korçës e pëlqente këtë zgjidhje⁵⁴.

Por, nga ana tjetër, ministri rumun në Shqipëri, Stojka nuk ishte i kënaqur me të drejtat që kishin vllahët dhe madje kishte marrë një pozicion ekstrem armiqësor kundrejt qeverisë shqiptare së cilës i kërkonte zgjerimin e gjeografisë së shkollave rumune në Shqipëri. Para se të transferohej në Sofje, ai mori një takim me diplomatit italian Soragna, të cilit i tha se Kryeministri P. Evangjeli, i cili kishte jetuar në Rumani dhe ishte shumë i afekcionuar nga ky vend, i kishte premtuar formalisht se do të hapej një shkollë fillore rumune në Elbasan. Por, ai kishte ndeshur në “intransigjencën nacionaliste” të ministrit të Arsimit. Këtë ai e kishte mësuar nga diskutimi i ashpër midis kryeministrit dhe ministrit të Arsimit, i cili kishte shkuar deri aty sa, ky i fundit kishte deklaruar se do të jepte dorëheqjen. Çështja kishte vajtur tek Mbreti, i cili kishte përkrahur mendimin e H. Mosit që, përkohësisht asnjë shkollë e re rumune të mos hapej. Kështu P. Evangjeli nuk kishte mundur ta mbante premtimin⁵⁵.

Stojka kishte shprehur pakënaqësinë ndaj “budallallëkut dhe keqdashjes së shqiptarëve të cilët kishin persekutuar elementin rumun”. I turbulluar nga ethet nacionaliste, Stojka pyeti diplomatit italian, duke shprehur njëkohësisht dëshirën e tij që Italia të merrte në dorë përgjithmonë administrimin e jetës së vendit, ose, më mirë akoma, ta

⁵³ *AQSH*, F. MPB, V. 1932, D. 183, fl.6. Inspektoria e Arsimit Korçë për Ministrinë e Arsimit, 30 shtator 1932.

⁵⁴ *Po aty*, fl.8. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 27 tetor 1932.

⁵⁵ *Po aty*.

pushtonte atë. Kështu, do të merrej me arumunët të cilët do t'i mbështeste pa vështirësi, duke i afruar në gjirin e qytetërimit të tyre të origjinës. Ai shtoi se për patriotët rumunë ishte e padurueshme ideja që bijtë e këtyre latinëve që kishin ruajtur prej shekujsh identitetin e tyre, ta humbisnin këtë, “duke e lënë të shuhej në trashësinë dhe primitivitetin e mentalitetit shqiptar”.

Më tej, Stojka theksoi se ishin të shumta kërkesat e kuqovllehve të Shqipërisë për t'u riatdhesuar në Rumani. Vetëm brenda një jave llogaritëshin 80 kërkesa të tilla. Ai mendonte se do të ishte e preferueshme që, në ato vende ku shqiptarët këmbëngulnin që të mos bënë lëshime për të drejtat e vllëve, të favorizohej emigracioni i tyre, meqë në Rumani kishte toka të mjaftueshme për të stabilizuar emigrantët. Pa saktësuar se çfarë do të propozonte konkretisht, ai i tha Soragna-s se do të fliste me mbretin rumun, duke i propozuar një politikë të qeverisë së Bukureshtit që të mos ftoheshin ndjenjat rumune ndaj Shqipërisë, gjë që do të ishte shumë e dëmshme për interesat shqiptare. Soragna mendonte se propozimet e tij nuk do përfilleshin nga mbreti rumun dhe shtonte se, mesa duket, Stojka nuk e njihte mirë karakterin e mbretit të tij, kur mendonte se kërkesa e një ministri do të kishte shumë efekt mbi të.⁵⁶

Kishte raste kur ndjenjat proshqiptare midis vllëve demonstroheshin në mënyrë kuptimplotë. E tillë ishte kërkesa e pleqësisë dhe parisë së fshatit Llëngë të Pogradecit, drejtuar nënprefekturës për transferimin e priftit të këtij fshati at Dhimitri Kokoneshit, sepse ai kishte filluar t'i zhvillonte meshat në gjuhën rumune⁵⁷. Ata nuk e konsideronin këtë fshat si minoritar dhe pohonin se prifti i lartpërmendur, kohë më parë ishte dorëzuar si prift shqiptar.

Me shtetëzimin e të gjitha shkollave private në vitin 1933 u përfshinë edhe shkollat vllahe. Por, menjëherë pas vendimit të Gjykatës së Hagës, qeveria shqiptare mori masa për rihapjen e tyre. Mbreti Zog njoftoi ministrin rumun se shkollat rumune do të rihapeshin në fillim të prillit. Por, ministri rumun u ankua në Ministrinë e Jashtme se dikasteri i Arsimit e kishte shtyrë çeljen e këtyre shkollave për në shtator. Ai pohoi se, “po ta njoftonte këtë lajm në Bukuresht, do ta vinte në një pozitë të vështirë Tituleskun para Mbretit të Rumanisë dhe qeverinë rumune ndaj

⁵⁶ *AQSH*, F. 163 (Legata Italiana), V. 1932, D. 320, fl. 1-2. A. Di Soragna për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Romë, 15 prill 1932.

⁵⁷ *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 164, fl. 63. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 16 maj 1934.

qarqeve maqedono-rumune⁵⁸. Prandaj, ai kërkoi çeljen e shkollave menjëherë.

Më tej, qeveria shqiptare vijoi të mbante një qëndrim dashamirës ndaj shkollave të vllahve. Ajo dha udhëzime që në fshatrat, ku sasia e vllahve ishte e konsiderueshme dhe ngulimet e tyre ishin të koncentruara, të futej pak nga pak, pranë gjuhës zyrtare, edhe gjuha rumune. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit ishte autorizuar që të shtonte edhe një klasë në shkollën vllahë të Korçës e cila ekzistonte prej shumë kohësh. Të gjitha këto masa do të realizoheshin në fillim të vitit shkollor 1936-1937, pasi të miratoheshin për çdo rast nga qeveria. Por, qeveria bënte të qartë se këto masa, në asnjë mënyrë, nuk duhej të jepnin përshtypjen e një autonomie shkollore, e cila ishte në kundërshtim me ligjet e shtetit shqiptar⁵⁹.

Qarqet nacionaliste greke, veçanërisht pas tërheqjes së qeverisë shqiptare nga shtetëzimi i shkollave minoritare, e shtuan entuziazmin dhe përpjekjet që, krahas ortodoksëve shqiptarë, të fuqizonin helenizmin edhe në komunitetin vllah në Shqipëri. Në vitin 1934 u vu re një përpjekje për të shtrirë influencën greke në dy fshatra me popullsi të përzier, shqiptare, vllahë e grekofone. Në fshatrat Vllaho-Psilloterë dhe Bjovizhdë të Përmetit vajti një prift nga Poliçani i Libohovës, i cili u fliste fëmijëve të atyre fshatrave në greqisht dhe meshat në kishat e këtyre fshatrave i zhvillonte gjithashtu në greqisht⁶⁰.

Nga ana tjetër, tashmë u shtuan përpjekjet e qeverisë rumune për të realizuar synimet e saj që kishin mbetur të pandryshuara. Më 5 maj të vitit 1937, legata rumune i paraqiti një notë Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë për hapjen e shkollave të vjetra rumune që kishin ekzistuar në periudhën e sundimit osman dhe ishin mbyllur në kohën e Luftës së Parë Botërore⁶¹. Legata rumune pretendonte se, në atë kohë, kishin funksionuar 15 shkolla rumune dhe kërkonte çeljen e tyre në Nicë, Lumba (Llenga), Grabovë, Voskopojë (Moscopol), Fier, Elbasan ose në Berat. Ajo kërkonte që shkollat e lartpërmendura të hapeshin në vitin shkollor

⁵⁸ AMPJ, V. 1935, D. 156, fl. 1-2. Ministri i Punëve të Jashtme drejtuar Mbretit Zog, 2 prill 1935.

⁵⁹ Po aty, V. 1936, D. 268, fl. 42. Pikëpamjet e qeverisë shqiptare për çështjen e shkollave vllahë.

⁶⁰ AQSH, F. MPB, V. 1934, D. 164, fl. 172. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 15 nëntor 1934.

⁶¹ AMPJ, V. 1937, D. 261, fl. 21. Përktimi shqip i promemories së legatës rumune në Tiranë për çeljen e shkollave të reja rumune, 5 maj 1937.

1937-1938. Ndërsa në vendet e tjera shkollat do të çelshin më vonë sipas nevojave që do të shfaqeshin. Kërkesën e saj për çeljen e shkollave legata rumune e mbështeste në premtimet zyrtare që kishte dhënë në vitin 1928 ish ministri i Jashtëm Iljaz Vrioni, për çeljen e shkollave rumune aty ku kishte një popullsi kompakte arumune; në faktin që qeveria shqiptare kishte qenë gati të nënshkruante një marrëveshje me Rumaninë për çeljen e një shkolle profesionale në Tiranë, e cila nuk ishte arritur për arsye të ndryshimeve në qeveri, shtetëzimit të shkollave dhe debatit që kishte filluar atëherë midis Shqipërisë e Greqisë për këtë çështje. Legata rumune përmendte qëndrimin në favor të Shqipërisë që kishte mbajtur qeveria rumune në Gjyqin e Hagës dhe faktin që ajo nuk kishte parashtruar pretendimet e saj, duke pritur përfundimin e grindjes me Greqinë. Gjithashtu, ajo pretendonte se në vitet 1934-1935 i ishte premtuar çelja e shkollave rumune nga Mbreti Zog, Rauf Fico, Xhaferi Vila dhe Pandeli Evangjeli. Madje, ky i fundit, duke vlerësuar besnikërinë e arumunëve të Shqipërisë ndaj shtetit shqiptar, kishte premtuar trajtim dhe lehtësi të njëjta me grekofonët e Jugut.

Legata rumune pohonte se Nica, Llënga dhe Grabova kishin afërsisht 50-60 fëmijë që dëshironin të ndiqnin shkollën rumune, Moskopoli, e banuar në tri pjesë nga arumunë, kishte patur një shkollë qysh në kohën e Turqisë, në Elbasan kishte afro 130 familje me 80-90 nxënës që mund të ndiqnin shkollën. Legata përcaktoi edhe listën e mësuesve që do të jepnin mësim në këto shkolla⁶².

Qeveria shqiptare pranoi sërish t'i plotësonte kërkesat e qeverisë rumune dhe të fuste mësimin e gjuhës rumune edhe në 5 shkolla të tjera (në shkollat e Llëngës, Nicës, Voskopojës, Grabovës dhe Frashërit), përveç dy shkollave që funksiononin prej vitesh. Ajo e konsideroi këtë si një koncesion maksimal për të plotësuar dëshirën e Rumanisë dhe për ta mbyllur çështjen përfundimisht. Por, ministri i Rumanisë në Tiranë, duke u mbështetur në një premtim që ishte bërë në vitin 1928, ngulte këmbë edhe për hapjen e një shkolle të pestë në një qendër me rëndësi, si Tirana⁶³. Megjithatë, më 24 korrik, ministri rumun në Tiranë, N. Lahovary falënderoi qeverinë shqiptare për futjen e mësimin të gjuhës rumune, ashtu siç praktikohet më parë, në shkollat e Korçës dhe Shpëskës

⁶² *Po aty*.

⁶³ *Po aty*, fl. 25. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar legatës shqiptare në Bukuresht, 17 korrik 1937; *po aty*, fl.39. E. Libohova për N. Lahovary, 24 korrik 1937.

edhe në shkollat e Voskopojës, Grabovës e Frashërit. Ai pohonte se “kjo iniciativë e qeverisë shqiptare do të vlerësohej si nga qeveria rumune ashtu dhe nga opinionimi publik rumun, si një provë e re e miqësisë shqiptare që konsolidon lidhjet e ngushta tradicionale që bashkojnë dy vendet tona”⁶⁴. Edhe nënsekretari i Jashtëm rumun i shprehu falënderimet e tij përfaqësuesit të Shqipërisë në Bukuresht për këtë vendim. Por, në të njëjtën kohë Farazi, një zyrtar tjetër i lartë në MPJ të Rumanisë, nuk e konsideroi çështjen të zgjidhur dhe këmbënguli që ajo duhej zgjidhur në parim. Për këtë arsye, do të ngarkohej përfaqësuesi rumun në Tiranë, Lahovari që të vijonte negociatat me qeverinë shqiptare⁶⁵.

I Ngarkuari me Punë i Shqipërisë në Bukuresht, Pandeli Nase mendonte se rumunët donin të krijonin në Shqipëri “një minoritet etnik të gjerë me tërë elementët e së drejtës ndërkombëtare, duke u mbështetur në deklaratën që kishte bërë Shqipëria në vitin 1921 në Lidhjen e Kombeve”. Ai shprehte dyshimin se hapja e 6 shkollave ishte pranuar nga pala rumune me paramendimin që më vonë të kërkohej çelja e shkollave në viset e tjera, ashtu siç funksiononin në kohën e Perandorisë Osmane⁶⁶. Disa ditë më vonë, Farazi i deklaroi Nases se këto shkolla do të ishin shtetërore, por do të kishin karakter minoritar, sipas pikëpamjes që kishte mbrojtur Shqipëria në Hagë⁶⁷.

Duke parë se rreth çështjes së shkollave rumune kishte ende paqartësi, Ministria e Jashtëm e Shqipërisë udhëzoi Pandeli Nasen që t’ua bënte të qartë autoriteteve rumune se, në bisedimet e mëparshme dypalëshe, nuk ishte folur për zbatimin e disa parimeve dhe as për t’ia lënë në dorë qeverisë rumune çeljen e shkollave rumune në Shqipëri por, ishte diskutuar dhe pranuar që të çelëshin disa shkolla në vende të ndryshme. Këto shkolla ishin shtetërore, domethënë çelëshin dhe mbaheshin nga Ministria e Arsimit, si gjithë shkollat e tjera të shtetit. Kështu që, nuk mund të flitej për dëshira të qeverisë rumune në këtë çështje. Masat që kishte marrë për çeljen e shkollave rumune, qeveria shqiptare nuk i lidhte me kërkesat që kishte bërë ministri i Rumanisë por

⁶⁴ *Po aty*, V. 1937, D. 261, fl. 40. Ministri i Rumanisë në Tiranë, N. Lahovary, për ministrin e Jashtëm, Ekrem Libohova, 24 korrik 1937.

⁶⁵ *AMPJ*, V. 1937, D. 261, fl. 49-50. Legata shqiptare në Bukuresht për Ministrinë e Punëve të Jashtëm, 22 korrik 1937.

⁶⁶ *Po aty*.

⁶⁷ *Po aty*, fl. 55. Legata shqiptare në Bukuresht për Ministrinë e Punëve të Jashtëm, 29 korrik 1937.

me konsideratat e veta të brendshme. Domethënë, ajo kishte marrë parasysh se një pjesë e popullsisë së fshatrave Llëngë, Nicë, Voskopojë, Grabovë dhe Frashër flisnin edhe gjuhën arumune, prandaj kishte vendosur të mësohej rumanisht në shkollat fillore të shtetit që funksiononin në ato vise. Me këtë vendim, qeveria shqiptare e konsideronte çështjen të mbyllur⁶⁸.

Diplomati britanik Weld Forester komentonte se ekzistenca në Shqipëri e një komuniteti kuovllah kishte qenë një burim grindjesh midis qeverive rumune e shqiptare këto 20 vitet e fundit, veçanërisht për çështjen e shkollave. Ai informonte Londrën se i Ngarkuari me Punë i Rumanisë i kishte thënë se qeveria e tij e kishte udhëzuar të bënte presion të fortë për çështjen e shkollave, se ideali i qeverisë rumune kishte qenë që të rikthejë pozitën që shkollat kuovllahe kishin në kohën turke, kur arrinin në 17 shkolla të tilla. Por objektivi imediat ishte të hapeshin 5 shkolla të reja nga dy që ekzistonin deri tani. I Ngarkuari me Punë i Rumanisë pohoi se qeveria rumune kishte kërkuar hapjen e 10 shkollave dhe koncesioni aktual që kishte bërë qeveria shqiptare ishte një kompromis.⁶⁹

Më 16 gusht 1937, Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e marrëveshjes që kishte arritur MPJ me legatën rumune mbi mësimin e gjuhës rumune në shkollat fillore të shtetit në fshatrat Llëngë, Nicë, Voskopojë, Grabovë e Frashër, njëloj me sistemin e pranuar në shkollat e Korçës dhe të Shpërkës. Ministria e Arsimit autorizojë për emërimin e mësuesve të përshtatshëm dhe për pagimin e tyre nga buxheti i saj, sipas orëve të mësimin që do të zhvillojnë⁷⁰.

Ministria e Arsimit udhëzoi Inspektorinë e Arsimit, Korçë që në shkollat ku do të lejohej mësimi i gjuhës rumune, fëmijët që flisnin rumanisht do të zhvillojnë mësimet të gjitha në gjuhën rumune (20 orë në javë), shqipja do të mësohej vetëm si gjuhë dhe çdo klasë do të kishte 8 orë mësimi në javë, veçmas ose kolektivisht. Gjuhën shqipe do ta jepte

⁶⁸ *Po aty*, fl. 54. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar Pandeli Nases, i Ngarkuari me Punë i Shqipërisë në Bukuresht, 6 gusht 1937.

⁶⁹ *TNA*, FO 371/21112. Weld-Forester për A. Eden, Durrës, 11 gusht 1937.

⁷⁰ *AMPJ*, V. 1937, D. 261, fl. 65. Vendim nr. 929, dt. 16 gusht 1937 i Këshillit të Ministrave.

gjithashtu mësuesi i rumanishtes. Programi i mësimëve do të ishte ai që zbatohet në shkollat e tjera shtetërore⁷¹.

Kur filloi aplikimi i këtij vendimi, doli problemi i numrit të nxënësve i cili ishte i vogël dhe nuk e përmbushte numrin që përcaktonte ligji për hapjen e shkollave. Inspektoria e Arsimit, Korçë informoi Ministrinë e Arsimit se banorët e Voskopojës flisnin të gjithë shqip dhe në marrëdhëniet midis tyre përdornin më tepër gjuhën shqipe. Ishin fare të pakët ata që nuk dinin shqip. Në raste dasmash apo vdekjesh, në familjet e atij fshati, këngët e vajtimet bëheshin rregullisht në gjuhën shqipe. Në familjet vllahe të fshatit ishin martuar shumë gra me origjinë shqiptare. Numri i fëmijëve të moshës shkollore që flisnin shqip e rumanisht ishte 100-110 dhe numri i atyre që nuk dinin fare rumanisht ishte rreth 20⁷². Ministria e Arsimit demonstroi në këtë rast vendosmërinë për zbatimin e angazhimeve të marra dhe dha udhëzime që shkollat në gjuhën rumune të funksiononin, pavarësisht nga numri i fëmijëve⁷³.

Në vitin 1938 u rishfaq sërish tendenca e disa familjeve vllahe për të emigruar në Rumani. Qeveria shqiptare u përpoq të pengonte largimin e tyre. Këto masa bënë që banorët e fshatrave Shipskë dhe Dishnicë t'i kërkonin ministrit të Rumanisë në Tiranë që të ndërhynte pranë qeverisë shqiptare që ajo të lejonte emigrimin e tyre familjarisht në Rumani dhe ky u kishte premtuar se do të ndërmjetësonte. Por, me sa duket, për të nxitur qëndrimin e tyre në Shqipëri, ai premtoi gjithashtu se vitin e ardhshëm shkollor, përveç shtimit të shkollave rumune në një raport më të favorshëm krahasuar me numrin e popullsisë kuovllahe në Shqipëri, do të shtohet dyfish edhe numri i bursave për djemtë që do të vazhdonin mësimet në Rumani. Gjithashtu, do të merreshin masa për ndreqjen e kishës rumune⁷⁴.

Në përfundim mund të thuhet se gjatë gjithë periudhës së qeverisjes së A. Zogut pati debate të vazhdueshme midis qeverive shqiptare e rumune për çështjen vllahe. Qeveria shqiptare e trajtoi me dashamirësi

⁷¹ *AQSH*, F. MA, V. 1937, D. 131, fl. 23. Ministria e Arsimit drejtuar Inspektorisë së Arsimit Korçë, 14 shtator 1937.

⁷² *Po aty*, fl. 22. Inspektoria e Arsimit Korçë për Ministrinë e Arsimit, 4 shtator 1937.

⁷³ *Po aty*, fl. 36. Ministria e Arsimit drejtuar Inspektorisë së Arsimit Korçë, 23 tetor 1937.

⁷⁴ *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 157, fl.1. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 22 nëntor 1938.

këtë pakicë etno-kulturore dhe i bëri disa lëshime qeverisë rumune, por nuk lejoi të realizoheshin synimet maksimaliste nacionaliste të saj.

S u m m a r y

NEGOTIATIONS BETWEEN THE ALBANIAN AND ROMANIAN GOVERNMENTS ABOUT THE PROBLEM OF THE VLACH MINORITY DURING 1925-1938

During Ahmet Zogu's rule, between 1925 and 1938, the Vlach ethno-cultural minority in Albania preserved the *status quo* of its schools which continued to function as they had done before. However, to a part of the Vlach community and to the Romanian government which acted as its patron, this was not enough. Their representatives made requests for the extension of education in the Romanian language and for more Vlach churches, as had been the case in the late ottoman period. The main advocate of such requests was the Romanian Minister in Tirana who followed a nationalistic approach aiming at the recognition of the Vlach ethno-cultural minority as a national minority and the recognition of the independent Vlach church by the Albanian government.

The Albanian government considered this attitude a personal initiative which went against the Romanian traditional policy, while the British representatives thought that his aim was to achieve something beyond the cultural recognition of the Vlachs and that he wanted to secure political advantages creating a Romanian minority in Albania. The British were of the opinion that the attempts to establish a minority which had not existed before were appalling.

The Romanian government tried to proceed with caution. In practice it continued to support its legation in Albania, but in the official meetings with the Albanian representatives maintained that it did not fully agree with this attitude and that it was reluctant for such recognition. However, it continuously put pressure on the Albanian government on this matter.

The Albanian government respected the *status quo* of the Vlach schools tolerating the support given by the Romanian government, although this was not officially recognized. In addition, between 1937 and 1938 the government gave permission for the opening of more Romanian schools in the districts of Llëngë, Nicë, Voskopojë, Grabovë and Frashër.

